

**AKT-THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“E&R Kokomani” SH.P.K**

**Sot me daten 25/01/ 2024,une ortaku themelues:**

Enider Kokomani atesia Ruzhdi dhe amesia Hajrije e datelindjes 22 Qershor 1995,lindur ne Durres dhe banues ne Shijak, rruga Vau Kokomaneve ,Erzen 00780052,Ndertesa 9, Hyrja 1 ,Gjepalaj Hardhishte kodi postar 2022 Shijak me status civil I martuar,mbajtes I leternjoftimit nr.037932078 date 15.11.2021 leshim I vlefshem deri ne date 14.11.2031 dhe numer personal identiteti J50622009H .

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit”,kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjsi te kufizuar “**E&R Kokomani” SH.P.K.**

**NENI 1**

**EMERTIMI I SHOQERISE**

Shoqeria do te quhet “E& R Kokomani” SH.P.K . dhe eshte person juridik shqiptar.Veprimtarija e saj rregullohet sipas neneve te ketij statute dhe Ligjit 9901 date 14.04.2008,si edhe Ligjit per QKB-ne.

**NENI 2**

**SELIA E SHOQERISE**

**Shoqeria do te kete seline e saj ne vendin e ushtrimit te aktivitetit :**

Durres,Xhafzotaj,Pjeze, Zona Kadastrale numer 2978,numer pasurie 59/19.

Shoqeria mund te krijojte filial ,zyra perfaqsimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

**NENI 3**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj:

Ofrim Pune krahu e thjeshte jo e specializuar e monitoruar nga prodhuesi per prodhimin e pllakave dekorative prej argjile ne ambientet e bizneseve prodhuese dhe tregtuese te tyre .  
Ushtrim te çdo veprimtarie tjeter tregtare te lejuar sipas Ligjit Shqiptar.

#### **NENI 4**

#### **KAPITALI I SHOQERISE**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë “E&R Kokomani” SH.P.K është

10.000,00(dhjetemije) leke.Ky kapital eshte I ndare ne 1 kuota

1. Enider Kokomani ,zoteron 100% te kapitalit.

#### **NENI 5**

#### **KOHEGJATJA E SHOQERISE**

Shoqerija do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohe te papercaktuar.

#### **NENI 6**

#### **ORGANET E SHOQERISE**

Organet e shoqerise jane:

-Asambleja e pergjithshme

-Administratoret.

#### **ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjse per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:

-Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.

-Ndryshimin e statutit.

-Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.

- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Perfaqsimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.
- Çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statute.

## **ADMINISTRATORET**

### Administratori I shoqerise do te jete shtetesi :

Enider Kokomani atesia Ruzhdi dhe amesia Hajrije e datelindjes 22 Qershor 1995,lindur ne Durres dhe banues ne Shijak, rruga Vau Kokomaneve ,Erzen 00780052,Ndertesa 9, Hyrja 1 ,Gjepalaj Hardhishte kodi postar 2022 Shijak me status civil I martuar,mbajtes I leternjoftimit nr.037932078 date 15.11.2021 leshim I vlefshem deri ne date 14.11.2031 dhe numer personal identiteti J50622009H .i cili emerohet per nje periudhe 5-vjeçare,me te drejte ripërteritje te ketij afati.

Administratoret mund te shkarkohen ne çdo moment nga asambleja ,me shumice te thjeshte vote ,me kusht qe ne mbledhje te marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

## **NENI 7**

### **SHPERNDARJA E FITIMIT VJETOR TE SHOQERISE**

Pjesa e fitimit qe I takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise,vendoset te shperndahet nga Asambleja e Pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme ka kompetence t`u shperndaje ortakeve pjesen e fitimit ne raport me vleren e kapitalit te rregjistruar ,qe kuotat e secilit ortak perfaqsojne.

Po ashtu, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve ,por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera,te cilat ajo I konsideron te dobishme per shoqerine.

## **NENI 8**

### **PRISHJA E SHOQERISE,LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE.**

#### Prishja e shoqerise

##### Shoqerija priset:

- a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- b)me vendim te asamblese se pergjithshme,
- c)me hapjen e procedurave te falimentimit,
- ç)nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 03.05.2007 per “QKR”,
- d)me vendim te gjykates,
- dh)per arsye te tjera,te parashikuara ne statut.

#### Largimi I ortakut

##### -Ortaku mund te largohet nga shoqeria:

- nese ortaket e tjere ose shoqeria kane kryer veprime ne dem te tij,
- nese eshte penguar te ushtroje te drejtat e tij,
- nese shoqeria I ka ngarkuar detyrime te pa arsyeshme apo,

Per shkaqe te tjera,qe e bejne te pamundur vazhdimin e ortakerise.

#### Perjashtimi I ortakut

Ne baze te nje vendimi te zakonshem, asambleja e pergjithshme mund ti kerkoje gjykates perjashtimin e ortakut,nese ai nuk ka shlyer kontributin e tij,sipas parashikimeve te statutit,ose nese ekzistojne shkaqe te tjera te arsyeshme per kete perjashtim,te parashikuara me ligj.

## **NENI 9**

### **LIKUIDIMI I SHOQERISE**

Ne rast te likuidimit te shoqerise,Asambleja e Pergjithshme emeron nje likuidator,I cili administron shoqerine deri ne mbylljen e proçesit te likuidimit.Me vendimin e posaçem te Asamblese se Pergjithshme,te marre me shumice te kualifikuar,pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise,likuidatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve.Kjo shperndarje e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te rregjistruar,qe kuotat e secilit ortak perfaqsojne.

## **NENI 10**

### **PERFUNDIMI I LIKUIDIMIT**

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura ,likujduesi e njofton Qendren Kombetare te Biznesit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon ç`rregjistrimin e shoqerise.

Veprimtaria e likuiduesit nuk mund te kundershohet pas ç`rregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare te Biznesit.

### **ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE "E&R Kokomani" SH.P.K.**

**Enider Kokomani**

*Enider Kokomani*

